

SAJBERDHUNA...
EDHE KJO ËSHTË
DHUNË!





Shoqërimi social dhe mundësitë e shumta që i ofron interneti janë karakteristikat e shekullit XXI, por a ke menduar ndonjëherë për rreziqet e mundshme në mjediset virtuale, dhe për atë se kush dhe si mund të jenë miqtë tu virtualë? **Sajberdhuna është problem real i ditëve të sotme, ndërsa viktimë mund të jetë çdokush, duke të përfshirë edhe ty.** Ja disa shembuj që do të ndihmojnë ta kuptosh se çka është sajberdhuna, çfarë formash merr, si të ballafaqohesh me të dhe si ta pengosh atë.

Botues: Fondacioni Metamorfozis

Për botuesin: Bardhyl Jashari

Autorë: Irina Shumadieva dhe Tamara Resavska

Përkthyes: Valon Abdiu

Lektura: Miftar Abdiu

Ilustrimet: Aleksandar Ordev

Dizajni grafik: Brigada Dizajn

Shtypi: Propoint

Kjo broshurë është përpiluar në kuadër të projektit **Privatësia në internet në mënyrë të lehtë**, i financuar nga Instituti shoqëri e hapur dhe Fondacioni shoqëri e hapur - Maqedoni.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
"Св. Климент Охридски", Скопје

177.3:004.738.5

177.3:621.395.721.5

SHUMADIEVA, Irina

Sajberdhuna --- edhe kjo është dhunë! / [autorë Irina Shumadieva i Tamara Resavska ; përkthyes Valon Abdiu]. -
Skopje : Fondacija Metamorfozis, 2011. - 20 str. : ilustr. ;
20 cm

Превод на делото: Сајбернасилство --- и тоа е насилство!
/ автори Ирина Шумадиева и Тамара Ресавска

ISBN 978-608-4564-12-6

1. Resavska, Tamara [автор]. - I. Шумадиева, Ирина види
Shumadieva, Irina
a) Кибер насилство
COBISS.MK-ID 88518666

ÇËSHTË SAJBERDHUNA?

Nëse je si shumica e tinejxherëve, atëherë pjesën më të madhe të kohës e kalon me celularin tënd ose në kompjuter, duke biseduar në çat me miqtë e tu, duke vënë fotografi, video dhe muzikë në rrjetet e ndryshme sociale, të cilat të mundësojnë shoqërim dhe zbavitje. Ndoshta ke miq onlajn, të cilët asnjëherë nuk i ke takuar në jetën reale, dhe me të cilët luan ose këmben porosi. Jeta jote zhvillohet njëkohësisht në disa vende, siç janë korridorët e shkollës, shtëpitë e miqve të tu, por edhe në internet.

Dhuna onlajn, e cila quhet sajberdhunë, ndodh kur fëmijët dhe tinejxherët, duke e shfrytëzuar internetin, celularët ose pajisjet e tjera teknologjike, shkruajnë informata fyese në formë të tekstit, të fotografive ose të përmbajtje të llojeve të tjera, me qëllim që të lëndojnë dhe të turpërojnë persona të tjerë.

Me fjalë të tjera,

sajberdhunë
kemi kur
dikush të
maltreton, të
shqetëson,
të nënçmon
ose në njëfarë
mënyre të
kushtëzon,
nëpërmjet
internetit ose
celularit.



Rasti i Xhulian Florit

Londër, 2008

E tëra filloi gjatë një ndeshjeje sportive në shkollën time, kur unë isha pjesë e një grupi të tifozëve. Pasi fitoi ekipi për të cilin unë bëja tifozllëk, vajzat e grupit kundërshtar ishin shumë të hidhëruara. Filluan të na shtynë.

Kur më panë ditën e ardhme në shkollë, filluan të më thërrasin me emra ofendues. I nxitën edhe nxënësit e tjerë që t'u bashkohen në dhunën e tyre. Më provokonin pa shkas, më shtynë nëpër korridor, më goditnin. Përfundova në spital pasi një herë aq shumë më shtynë, sa që e lëndova kokën në beton dhe mora tronditje në tru.

Fillova të frikësohem për sigurinë time. U mbylla në shtëpi. Isha shumë e zhgënjyer, e frikësuar, e shqetësuar, e nervozuar, e deprimuar... Mendoja se në shtëpi isha e sigurt. Por, në shtëpi kam internet, dhe punët u keqësuan edhe më tepër. Kërcënimet onlajn ishin edhe më serioze. Nëpërmjet e-mailit, mesenxherit, Facebook-ut... s'është me rëndësi, prej çdokund pranoja ofendime. Vazhdova të bisedoj me to, me qëllim që t'ua kthej, t'i detyroj të ndalen, por punët shkonin gjithnjë e më keq. Më quanin e trashë, e marrë, kurrkushi...

Në fund i tregova nënës sime. Ajo shtypi kopje të ofendimeve dhe shkoi në polici. Ata i gjetën vajzat dhe lëshuan ndalesë kundër shqetësimeve, që do të thoshte se ato nuk mund as të më afroreshin dhe as të më kontaktojnë. Njëra vajzë aspak nuk ka ndryshuar, mbeti në rrugë, shoqërohet me njerëz të gabuar, mirëpo tjetra erdhi dhe më kërkoi falje. Tashmë nuk kam frikë pasi e di si të veprojmë dhe çka nuk duhet të bëjmë.



KESHILLA:

- 🔍 Blllokoje komunikimin me sajberdhunuesit. Mos e hap dhe mos u përgjigj në e-mailat ose në porositë e dikujt, për të cilin e di se është sajberdhunues.
- 🔍 Mos dërgo porosi kur je e/i hidhëruar. Prit të të kalojë hidhërimi që të mos thuash diçka për të cilën më vonë do të pendohesh. Mos e vazhdo sajberdhunën!!!
- 🔍 Bisedo me prindërit e tu për atë që e bën në internet dhe njoftoji të rriturit më të afërt për sajberdhunuesin. Tregojua porositë dhe kërkoni ndihmë.
- 🔍 Ruaji ose shtypi të gjitha porositë e dhunuesëve, si argumente të cilat mund tua tregosh përgjegjësve në shkollë, ofruesve të shërbimeve të internetit, e bile edhe policisë, të cilët pastaj do të merren në mënyrë adekuate me dhunuesin.



Rasti i Dejvid Najtit

Berlington, Ontario

Dejvid Najti me vite ka qenë i ngacmuar nga shokët e tij. Por, ngacmimet janë bërë të padurueshme kur mori porosi me link për te ueb-faqja të cilën mund ta shikonin të gjithë shfrytëzuesit e internetit, ndërsa ishte krijuar me qëllim që të ofendohet dhe të përqeshet Dejvidi dhe familja e tij. Ueb-faqja ishte aktive disa muaj, para se ai ta kuptojë këtë.

“Në ueb-faqe kishte gjithçka për mua, se jam homoseksual, se dua djem më të rinj, se shfrytëzoj drogë, e të ngjashme.”

Këtyre ofendimeve iu bashkuan edhe ofendime të tjera nëpërmjet të e-mailit.

Nëna e tij thotë se kur Dejvidi e ka kuptuar këtë, ka filluar të tërhiqet dhe të izolohet nga të tjerët. Dejvidi frikësohej se të gjithë e dinë për ueb-faqen, u tërhoq dhe u izolua nga të tjerët, u largua nga shkolla dhe vitin e fundit e kreu si i çrregullt, duke mësuar në shtëpi.

“Unë kam të drejtë të futem në internet ose ta shfrytëzoj celularin tim, pa i pranuar ato porosi. Gjithashtu, mund të mbyllesh në dhomën tënde dhe atje ta kalosh pjesën tjetër të jetës, por kjo nuk është zgjidhje.”

Në fund, familja Najt e gjeti informatën për atë se ku është e hostuar ueb-faqja, dhe pas disa kërkesave të njëpasnjëshme, arritën të ndikojnë që ai të fshihet.

Pas kësaj, Dejvidi mundi të këndellej nga të gjithë sajberofendimet që i ka përjetuar dhe ka vazhduar ta jetojë ëndrrën e tij. Filloi të marrë orë për fluturime, duke shpresuar se do të bëhet pilot.



KËSHILLA:

- Q Sot është lehtë që çdokush të krijojë ueb-faqe ose blog, ku mund të ketë qasje secili. Ekzistojnë njerëz që me qëllim bëjnë ueb-faqe ku do të mund të vihen ofendime për persona të caktuar ose për grupe njerëzish.
- Q Interneti mundëson fshehjen e identitetit personal dhe hapjen e ueb-faqeve, të adresave të e-mailit dhe të profileve të rrjeteve sociale në mënyrë anonime. Gjithashtu, ky anonimitet është mit. Çdoherë ekzistojnë gjurmë nga ajo që e bëjnë dhunuesit, duke u përfshirë edhe ty, nëse bën një gjë të tillë.
- Q Ndonjëherë mund të lënë edhe të dhëna të tua personale dhe fotografi në internet, duke të vënë në rrezik më të madh që të të kontaktojnë ose të të gjejnë. Në këtë rast, dhuna onlajn bëhet problem real.
- Q Në rast se je viktimë e sajberdhunës, mos hesht dhe mos u tërhiq në vete. Tregoju prindërve, bashkë do të gjeni zgjidhje.



Mirë se erdhe në ueb-faqen për talljen e Dejvid Najtit

Dejvidi është homoseksual

“I pëlqej djemtë e ri” – Dejvid Najt (ha-ha-ha)



**Çka më thotë më shpesh Dejvidi?
- “Më jepni droooooogë”**



Prej profilit të rrejshëm gjer te kërcënimi i vërtetë

Për mua ishte shok i vërtetë kur pashë profil në Facebook me fotografinë time dhe me emrin tim, por jo atë që e kisha krijuar vetë. Nga miqtë e mi kuptova se u paskam dërguar porosi, duke u thënë se ky është profili im i ri, për shkak se dikush ka depërtuar profilin tim paraprak, prandaj duhet ta bllokojnë atë.

Pas një kohe, miqtë e mi filluan të marrin porosi prej meje me fjalë të pahijshme. Kur kuptova, u thash se nuk jam unë ai/ajo që ua ka dërguar këto porosi dhe se dikush e shfrytëzon profilin në emrin tim, duke u paraqitur në mënyrë të rrejshme. Por, dëmi më ishte bërë. E pashë se ekziston edhe një grup ku janë anëtarësuar rreth 100 anëtarë, ku shkruhen ofendime të ndryshme për mua, duke më quajtur me lloj-lloj emrash ofendues, duke thënë se jam shtatëzane dhe se kam sëmundje ngjithëse seksuale.

Punët nuk përfunduan këtu. Filluan të më vijnë edhe porosi në celular nga numra të ndryshëm, me të cilat më kërcënoheshin se do të më rrahin në rrugë, se do të më vrasin nëse më shohin. U frikësova seriozisht. Nuk dija ç'të bëja. U tregova prindërve dhe ata më shoqëronin kur shkoja në shkollë... gjersa punët nuk ranë në vendin e vet.

SAJBERDHUNUESIT:

- ➡ krijojnë profile të rrejshme në ueb-faqet për rrjetëzim social ose lënë porosi ofenduese në profilet e ekzistuese
- ➡ paraqiten me identitet onlajn të rrejshëm, që t'i mashtrojnë të tjerët që t'ua zbulojnë të dhënat personale të mikut të tyre
- ➡ shfrytëzojnë llogari të huaja të shfrytëzuesit që t'u dërgojnë porosi ofenduese njerëzve të tjerë ose që të publikojnë fotografi të viktimave pa lejen e tyre
- ➡ përhapin gënjeshtër dhe thashetheme.



KËSHILLA:

Nëse e di ueb-faqen ku është krijuar profili i rrejshëm, ekzistojnë dy veprime që mund t'i bësh:



Përdore sistemin për fjalëkalimet e harruara të ueb-faqes, që të mundohesh t'i qasësh profilin. Nëse dhunuesi e ka shfrytëzuar e-mail adresën tënde gjatë krijimit të profilin, kjo do të duhej të ishte relativisht e lehtë. Shumica e sistemeve për kthimin e fjalëkalimeve të harruara i shfrytëzojnë e-mail adresat e shfrytëzuesve që t'ua dërgojnë ato si porosi, me kërkesen e tyre. Pasi ta marrësh fjalëkalimin, mundesh edhe vet ta fshish profilin.



Kontaktoje administratorin e ueb-faqes dhe kërko që profili të largohet. Nëse ke më pak se 18 vjet, informimi i administratorit të ueb-faqes se je i mitur, zakonisht inicon përgjigje më të shpejtë. Mund të mendosh që kërkesën ta bëjnë edhe prindërit e tu.



ME RËNDËSI

Sajberdhuna, zakonisht nuk ndodh me vetëm një komunikim, por mund të të ndodhë vetëm një herë dhe të ketë kërcënim me vdekje ose frikësim serioz për shkaktimin e lëndimeve trupore.



PËR ÇDO RAST:

Bëhu i sigurt se ke ruajtur një kopje nga profili, para se të ndryshohet ose të hiqet, sipas mundësisë me ndihmën e ndonjë programi për inçizim të ueb-faqeve. Mundohu ta inçizosh faqen në hard-diskun tënd dhe ta dokumentosh tërë komunikimin me administratorin e ueb-faqes.

Më shqetësoi në çat

Isha futur në një dhomë për çat, kur një djalë filloi të më shqetësojë seksualisht, duke më thënë lloj-lloj gjërash. Nuk më linte rehat.

Isha e detyruar ta lëshoj dhomën për çat dhe ta bllokoi e-mailin.

SAJBERDHUNUESIT:

I shfrytëzojnë mesenxherët dhe dhomat për çat, për të dërguar porosi kërcënuese ose ofenduese.



KËSHILLA:

- Asnjëherë mos iu përgjigj dhunuesit. Mënyra më e shpejtë që t'i vihet fund shqetësimit nëpërmjet çatit është që të dilet nga dhoma për çat ose të bllokohet shfrytëzuesi i aplikacionit.
- Mendo për krijimin e hapësirave virtuale për bisedë, vetëm ndërmjet teje dhe miqëve të tu, të cilat funksionojnë me dërgimin e ftesave private.
- Njoftoje moderatorin ose përgjegjësën e dhomës për çat, për situatën e dhënë. Kërko që tabela e shpalljeve të mbyllet ose të suspendohet, deri sa të mos hiqen postimet.
- Edhe një herë, sigurohu se i ke njoftuar prindërit tuaj dhe/ose përfaqësuesit e shkollës nëse shqetësimet vazhdojnë, eskalojnë ose paraqesin vazhdimin e dhunës në shkollë.



Sajberdhunueset

Ana dhe Marija ishin shoqe shumë të ngushta. Ndanin çdo gjë. I dinin bile edhe fjalëkalimet e e-mail adresave të tyre, fjalëkalimet e mesenxherit dhe të profileve të tyre në rrjetat sociale.

Marija u njoftua me Martinin dhe dalëngadalë filloi të kalojë gjithnjë e më shumë kohë me të. S'kishte aq kohë për Anën dhe filloi të shoqërohet me "vajzat e shoqërisë së lartë", siç i quanin. Ato i nënçmonin të gjitha nxënëset e klasës, duke menduar se janë më të mira se ato.

Shoqëria e lartë e shfrytëzoi miqësinë e Anës që ta detyrojë atë të hyjë në llogarinë e Marijës në My Space, me qëllim që të tallen me të. Ana ishte e hidhëruar se Marija nuk i kushtonte shumë kujdes në kohët e fundit, dhe disi donte t'ia kthejë. Në profilin e Marijës vendosën fotografi lakuriqe, të cilat Ana i kishte prej kohës kur dy shoqet më të ngushta fotografoheshin me shaka. U shkruanin porosi miqëve të Marijës. E ndërruan fjalëkalimin, kështu që ajo nuk mundte as të hyjë në profilin e saj.

Kur Marija e kuptoi se kush qëndron pas gjithë kësaj, u hidhërua shumë. Filloi të dërgojë porosi te shoqet e saja duke thënë se Ana është "mizerje prej njeriu" dhe ofendime të tjera. Nuk kaloi shumë kohë, kur për këtë kuptuan prindërit e tyre dhe përgjegjësit e shkollës.



KËSHILLA:

- 🔍 Ruaje fjalkalimin tënd! Mund ta ndash me prindërit e tu, por me askë tjetër, as me shokun/shoqen tënd/e më të ngushtë!
- 🔍 Rregulloji llogaritë e tua të shfrytëzuesit për e-mail dhe për mesenxher, bashkë me prindërit e tu. Mos e vendos emrin tënd të plotë, moshën, adresën ose numrin e telefonit në profilin tënd ose si pjesë të emrit të shfytëzuesit. Këto të dhëna mund të keqpërdoren.

SAJBERDHUNUESI:

- ➡ Mund ta shfrytëzosh fjalëkalimin tënd dhe të fillojë të bisedojë me njerëz të tjerë, duke u paraqitur kinse je ti. Ai mund të thotë gjëra të këqija, që i ofendojnë dhe i hidhërojnë miqtë e tu, e ndoshta janë ofenduese edhe për dikë që nuk e njeh. Në ndërkohë, miqtë e tu as që do ta dijnë se nuk bisedojnë me ty.
- ➡ Mund të të pamundësojë qasje te profili yt ose ta ndryshojë dhe të futë në të përmbajtje raciste, seksuale dhe të pahijshme, që mund të tërheqin vëmendje të padëshiruar ose të ofendojnë dikë.
- ➡ Mund të dërgojë e-mail porosi masovike gjer te shfrytëzuesit e tjerë, në të cilat do të ketë lakuriqësi ose fotografi nënçmuese të tua ose të njerëzve që ti i njeh. Pasi të jetë dërguar një porosi e tillë, nuk ekziston mënyrë që të kontrollohet ku do të shkojë.

Fotografitë "lakuriqe"

Me shogen time u fotografuam me celular, duke pozuar lakuriqe, si fotomodelet e njohura. Mendoja se ishte interesante, gjersa s'kuptova se ajo i ka shpërndarë fotografitë tona te disa shokë të saj. Dihet se asaj i ka interesuar diçka tjetër...

Fotografitë shpërndaheshin me shpejtësinë e dritës, ndërmjet njerëzve që i njoh dhe atyre që nuk i njoh... E kuptoi e gjithë shkolla. Filluan të më arrijnë e-maile me oferta të pahijshme. Pranoja edhe disa reklama, si të faqeve pornografike. Më vonë kuptuan edhe prindërit e mi. Kurrë nuk jam ndjerë aq e turpëruar.



KËSHILLA:

- Q Mos i ndaj fshehtësitë, fotografitë ose çkado qoftë në internet, që do të mund të ishte e pakëndshme nëse për të merr vesh dikush, p.sh. e tërë shkolla.
- Q Kurrë mos i publiko dhe mos i ndaj me të tjerët të dhënat tua personale në internet (emrin dhe mbiemrin tënd, adresën, numrin e telefonit, emrin e shkollës tënde, emrat e prindërve të tu, numrat e kartelave të tyre të bankës) ose të dhënat personale të shokëve të tu.

SAJBERDHUNUESI:

- ➡ Mund të të fotografojë në zheshtore dhe pastaj këtë fotografi ta publikojë onlajn, ose t'ua dërgojë fëmijëve të tjerë duke shfrytëzuar celular ose e-mail.
- ➡ Dikush mund të të regjistrojë për pranimin e e-mail porosive nga listat e marketingut, veçanërisht nga ueb-faqet pornografike. Kur do të marrësh me mijëra e-maile me përmbajtje pornografike, me siguri do ta marrin vesh edhe prindërit e tu, dhe mund të akuzohesh gabimisht se ke vizituar faqe pornografike.

- ➡ E shfrytëzon celularin që të dërgojë tekst, video, fotografi ose lloje tjera të përmbajtjeve ofenduese, nga individë të tjerë, pa lejen e tyre.



Shqetësimet më dekoncentronin në shkollë

Shqetësimet më dekoncentronin në shkollë Njëri nga „shokët“ e mi filloi të më ofendojë në MSN. Më dërgonte porosi të pahijshme, më vonë edhe nëpërmjet e-majlit dhe ky shqetësim vazhdoi edhe në shkollë. Isha i sulmuar me fjalë të këqija çdokund, në internet dhe fizikisht. Më kërcënohej. S'kisha ku të fshihem. Nuk mundja të koncentrohem në detyrat shkollore. Gjithmonë isha i shqetësuar dhe i frikësuar. Më vinte turp t'u tregoj prindërve...

ME RËNDËSI: Sajberdhuna ka pasoja serioze. Viktimat ndjejnë:

- ➡ vetëbesim të zvogëluar
- ➡ pasiguri
- ➡ fatkeqësi
- ➡ frikë
- ➡ frustracion
- ➡ tërbim
- ➡ depresion
- ➡ shqetësim
- ➡ pikëllim
- ➡ hanë dhe pinë më pak
- ➡ lëshojnë në mësim
- ➡ kundërvihen me sajberdhunë
- ➡ kanë prirje të shtuar për vetëvrasje
- ➡ bëjnë vetëvrasje



KËSHILLA:

- 🔍 Ruaji të gjitha porositë kërcënuese dhe shqetësuese në folder të veçantë të kompjuterit.
- 🔍 Rregulloji parametrat e e-mailit tënd, ashtu që kur dhunuesi do të të dërgojë ndonjë porosi, ajo automatikisht të hyjë në folderin e caktuar. Kështu do t'i ruash faktet në vend të sigurt, por nuk është e thënë që ta shohësh përmbajtjen.



VËREJTJE: Çka s'është sajberdhunë?

Te sajberdhuna medoemos të ketë të mitur nga të dyja anët ose ajo të jetë e nxitur nga një i mitur kundër një të mituri tjetër. Në momentim kur futen të rriturit, bëhet fjalë për sajbermaltretim ose sajberkërcënim.





Fëmija nga Lufta e yjeve

Djaloshi - adhures i “Luftës së yjeve” ka inçizuar një video shtëpiake ku mund të shihet se si duke e përdorur shkopin për golf si shpatë ndriçuese, imiton skena nga filmi. Ai bile i imiton edhe efektet e zërit. Por, qëllimi i tij ishte që videoja të mbetet private.










Disa prej shokëve të tij klasës e kanë gjetur videon dhe e kanë vënë në internet, prej ku e kanë shkarkuar shumë njerëz. Janë përpiluar edhe versione të tjera, ku koka e djaloshit ka qenë e vendosur në filmat si “Matriks” ose “Zotëriu i unazave”. Disa emisione e kanë emituar videon.

Tinejxheri është dashur të ballafaqohet me turpin për shkak të videos së vendosur në internet, e cila ka qenë e ndarë me publikun e gjithë botës. Fëmija është shqetësuar aq shumë nga situata, sa që ka qenë e nevojshme të jetë nën mbikëqyrjen e psikiatrit. E ka ndërruar shkollën, ndërsa prindërit e tij kanë parashtruar padi në emër të tij.

KARAKTERISTIKAT E SAJBERDHUNËS:

-  Sjellja negative ose e rrezikshme
-  Shkaktimi i qëllimshëm i dëmit
-  Forca e pabarabartë në mes të sajberdhunuesit dhe viktimës
-  Përsëritja e sjelljes së dhunshme

DISA TË DHËNA STATISTIKORE

-  33% e të rinjve kanë qenë viktimë të sajberdhunës.
-  Forma më e shpeshtë e sajberdhunës është injorimi dhe mosrespektimi.
-  Më shumë viktimë të sajberdhunës ka në dhomat për çat, e pastaj në komunikimin nëpërmjet mesenxherëve dhe nëpërmjet e-mailit.
-  34% e të rinjve që kanë qenë viktimë të sajberdhunës, ndjehen të frustruar, 30% janë të zemëruar, ndërsa 22% janë të pikëlluar.
-  Vajzat të cilat janë viktimë të sajberdhunës ndjejnë shumë më tepër zemërim se sa djemtë.
-  41% e viktimave të sajberdhunës, nuk i kanë treguar askujt për këtë në jetën reale, mirëpo 38% i kanë treguar në besim ndonjë shoku/shoqeje onlajn.
-  Vetëm 19% e viktimave i kanë treguar dikujt për sajberdhunën.
-  17% kanë pranuar se kanë kryer sajberdhunë.
-  Më shumë se gjysma e atyre që kanë marrë pjesë në hulumtim, konsiderojnë se sajberdhuna është diçka e keqe, bile edhe më e keqe se dhuna në jetën reale.

(Burimi: Qendra hulumtuese për sajberdhunë në SHBA, shkurt, 2010, www.cyberbullying.us)



ÇKA E KARAKTERIZON SAJBERDHUNUESIN?

- 🔍 s'ka lidhje të forta me prindërit dhe arsimtarët e tij
- 🔍 dëshiron të dominojë mbi njerëzit e tjerë
- 🔍 dëshiron t'i shfrytëzojë njerëzit e tjerë për ta fituar atë që e do
- 🔍 nuk e sheh situatën nga perspektiva e huaj
- 🔍 fajëson, kritikon dhe jep arsyetime të rrejshme për sjelljen e tij të pahishme ndaj viktimës
- 🔍 nuk pranon përgjegjësi për veprimet e veta
- 🔍 ka dëshirë t'i kushtohet kujdes
- 🔍 është dhunues
- 🔍 ndjen shqetësim social
- 🔍 është përdorues i shkathtë i internetit, ka vetëbesim në shkathtësitë e veta
- 🔍 edhe vetë mund të jetë viktimë e sajberdhunës

Sajberdhunuesit bëjnë keqpërdorimin e të dhënave personale, publikojnë fotografi, të dhëna personale ose komente të rrejshme dhe blogojnë në ueb-faqe, ku komentet e tyre mund të shihen prej çdokujt, pa lejen tuaj

FORMAT E SAJBERDHUNËS:

- ➡ **shqetësimi** –dërgimi i vazhdueshëm i porosive ofenduese, shqetësuese dhe i materialeve pornografike
- ➡ **imitimi** – depërtimi në llogaritë e huaja të shfrytëzuesit dhe dërgimi i porosive të rrejshme dhe të turpshme në emër të huaj
- ➡ **nënçmimi** – shkruarja e thashethemeve dhe e deklaratave të tjera të pavërteta që mund t'i bëjnë dëm viktimës, si dhe fotografi me përmbajtje nënçmuese dhe informata personale të turpshme si dhe dërgimin dhe publikimin e tyre në internet
- ➡ **mashtrimi dhe zbulimi publik** –ndarja me të tjerët e informatave të huaja personale ose mashtrimi i dikujt për t'i ndarë fshetësitë e veta me qëllim që tua dërgojë të tjerëve
- ➡ **të shprehurit vullgar** –dërgimi i porosive të hidhura me përmbajtje vullgare
- ➡ **sajberkërcënimi** – frikësimi konstant i viktimës për sigurinë e tij
- ➡ **përrjashtimi nga mjedisi social**

SI DALLONET SAJBERDHUNA NGA DHUNA E RËNDOMTË?

- Q **mund të ndodhë në shtëpinë e fëmijës-viktimë** –ku ai zakonisht do të ndjehej i sigurt
- Q **mund të jetë shumë më e vrazhdë** – fëmijët kanë më tepër guxim të thonë fjalë të këqija në internet, shpeshherë përshkak se nuk do të ballafaqohen me reagimet e bashkëbiseduesve
- Q **ka shtrirje më të madhe** – sajberdhunuesit shumë lehtë mund ta përqeshin dikë para gjithë klasës, me vetëm disa klikime ose të harxhojnë disa minuta për të krijuar një ueb-faqe me përmbajtje ofenduese, të cilën mund ta shohë e tërë bota
- Q **është anonime** – më shpesh, sajberdhunuesit fshihen pas emrave të shfrytëzuesve dhe pas e-mail adresave që nuk mund të identifikohen. Shumica e sajberdhunuesve i njohin viktimat e tyre, por shumica e viktimave nuk e dijnë se kush i sulmon. Kjo krijon pasiguri plotësuese te viktimat.

ÇKA NËSE JAM VIKTIMË E SAJBERDHUNËS?

- Q Nëse të dhënat tua personale janë keqpërdorur në internet, rastin mund ta paraqesish në Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale (www.dzlp.mk).
- Q Për rastet e rënda të sajberdhunës, ku ka kërcënime, mund të drejtohesh në polici, së bashku me prindërit e tu.
- Q Paraqiti keqpërdorimet në ueb-faqet dhe në rrjetet sociale nëpërmjet opsioneve përkatëse ose drejtpërdrejt tek administratori i tyre.

KËSHILLA TË SHPEJTA PËR PENGIMIN E SAJBERDHUNËS:

- 🔍 Mos i zbulo të dhënat tua personale në internet.
- 🔍 Mos i trego fjalëkalimet tua.
- 🔍 Mos i përgjigj porosive të dhunshme, vetëm ruaji si dëshmi.
- 🔍 Mos i hap porositë nga dërguesit e panjohur ose nga fëmijë që i di se janë dhunues.
- 🔍 Mos publiko në internet diçka që nuk dëshiron ta dijë e gjithë klasa.
- 🔍 Mos dërgo porosi kur je i/e hidhëruar.
- 🔍 Mos iu bashkangjit sajberdhunës. Nëse e vëren, paraqite te ndonjë më i rritur.

NËSE DIÇKA NUK DO T'IA TROJE DIKUJT NË FYTYRË, MOS IA THUAJ AS ONLAJNI!

EDHE SAJBERGODITJA DHUMB!

Informohu për sigurinë tënde në internet:

Shih filma të shkurtër dhe interesantë www.internetisigurt.org.mk/filma

dhe luaj lojëra zbavitëse: www.internetisigurt.org.mk/lojera



METAMORPHOSIS

E përkrahur nga

